



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 288/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Subjektit Politik (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Malishevë, për shkak dorëzimit të rrejtshëm të emrave për komisioner nga ana e Besim Bytyqi, për zgjedhjet e 12 Dhjetorit në emër të subjektit politik Fryma e Re në KKZ në Malishevë, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2010, mori këtë:

V E N D I M

PZAP shpallet jokompetent.
Hidhet poshtë ankesa si e palejuar

A R S Y E T I M I

Subjekti politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, ka parashtruar një ankesë me datën 23.11.2010 më të cilën pretendon se Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Malishevë, ka bërë shkelje të rëndë ligjore me të cilën ka bërë regjistrimin e rrejtshëm të emrave për komisioner për Zgjedhjet e 12 dhjetorit në emër të subjektit politik Fryma së Re (FER) në KKZ në Malishevë, për procesin e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare.

F A K T E T

Me 23.11.2010, subjekti politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë ka pohuar që sipas informatave zyrtare që posedon nga Rexhep Zogaj nga KKZ, dorëzimi i listës në emër të (FER-it) në mënyrë të rrejtshme është bërë nga Besim Bytyqi nga fshati Shkozë, komuna e Malishevës. Po ashtu, parashtruesi i ankesës ka përmendur këta emra që janë dorëzuar rrejtshëm në emër të subjektit të tyre politik: Faruk Kastrati, Selim Robaj, Vllaznim Krasniqi, Donika Krasniqi, Brahim Morina, Arton Hoti, Reshit Begaj, Sherif Morina, Fatmir Samadraxha, Astrit Mazreku, Selajdin Morina, Burim Pacarizi, Hasan Kastrati, Hajredin Kastrati, Elez Kastrati, Fadil Morina dhe Astrit Mazreku. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore për rastin konkret, dhe të largohen këta emra nga lista e komisionarëve të KKZ-së.

ANALIZË

Juridiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP*, Ligji Nr.03/L – 256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 073 dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës Ligji Nr. 03/L- 072*.

Neni 122. 1 i LZP-së

Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në PZAP:

- a) përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;*
- b) certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;*
- c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;*
- d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;*
- e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji;*
- f) refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.*

Pretendimet e parashtruara nga ankuesi nuk janë nën juridiksionin e PZAP-it, ngase në PZAP mund të ankimohen vetëm vendimet e KQZ-së. Më asnjë dispozitë të LZP-së e as më ndonjë dispozitë tjetër nuk është parashikuar mundësia e ushtrimit të ankesës në PZAP, kundër vendimit të KKZ.

Meqë kundër vendimit të KKZ nuk është e lejuar të ushtrohet ankesë në PZAP, në përputhje me dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 288/2010 më datën 24.11.2010.

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

